

Nga 1 prilli hyri në fuqi regjistrimi i dëmeve për historikun e “*Bonus-Malus*”

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-mars 2019
- Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë, janar-mars 2019

Zhvillime të tjera

- AMF pjesëmarrëse në takimet shpjeguese të Komisionit Evropian për Kapitullin e 9-të “Shërbimet Financiare”
- Takim rajonal për financimin e zvogëlimit të rrezikut të fatkeqësive për Ballkanin Perëndimor
- AMF dërgon për konsultim publik projektligje lidhur me tregun e kapitalit
- Zhvillohet trajnimi për subjektet e mbikëqyrura nga Autoriteti
- AMF pjesëmarrëse në takimin e tretë të Komitetit Drejtues të Instrumentit Horizontal të Bashkimit Evropian

Edukimi i Konsumatorit

- Të kursesh mjaftueshëm, mirë dhe në mënyrë inteligjente (*pjesa e dytë dhe e fundit*)

Botime Profesionale

Lajme Ndërkombëtare

- Bosnje dhe Hercegovinë
- Maqedoni e Veriut
- Qipro
- Serbi
- Sllovaki

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Nga 1 prilli hyri në fuqi regjistrimi i dëmeve për historikun e “*Bonus-Malus*”

Në bazë të udhëzimit “Mbi zbatimin e sistemit *Bonus-Malus* në sigurimin MTPL e brendshme”, të miratuar në mbledhjen e Bordit të AMF-së, duke nisur nga data 1 prill hyri në fuqi regjistrimi i dëmeve për mbajtjen e historikut. Në rastet kur drejtuesit e mjeteve bëhen shkaktarë të aksidenteve do të kenë rritje të çmimit të siguracionit, duke nisur nga viti i ardhshëm.

Drejtuesit e kujdesshëm, që nuk do të realizojnë aksidente në këtë periudhë do të përfitojnë ulje në çmimin e siguracionit TPL, duke filluar nga viti i ardhshëm. Vendimi i Bordit të Autoritetit u mor në kuadër të mbrojtjes konsumatore dhe zhvillimit të tregut të sigurimeve. Nga ana teknike procesi është transparent dhe përfshirja e formulave matematikore e bën një mekanizëm të drejtë, të besueshëm dhe sipas meritës.

Me qëllim kryesor mbrojtjen e konsumatorit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare realizoi një numër publikimesh në media, të shkruar e vizive, në mënyrë që konsumatori të ishte sa më i qartë mbi mënyrën se si do të zbatohet udhëzimi.

—◇◇◇—
Në bazë të udhëzimit
“Mbi zbatimin e sistemit
Bonus-Malus në
sigurimin MTPL e
brendshme”, të
miratuar në mbledhjen
e Bordit të AMF-së,
prej 1 prillit hyri në fuqi
regjistrimi i dëmeve për
mbajtjen e historikut.
—◇◇◇—

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-mars 2019


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për janar-mars 2019 kapën vlerën mbi 3,969 milionë lekë, ose 11.78% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Gjatë periudhës janar-mars 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 276,006 me një rritje 5.68% krahasuar me periudhën janar-mars 2018.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.78 % të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 7.25% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.97%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 41.93% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 58.07% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-mars 2019, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 1,501 milionë lekë, ose 11.82% më shumë se në periudhën janar-mars 2018.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për janar-mars 2019 kapën vlerën mbi 3,969 milionë lekë, ose 11.78% më shumë se në periudhën janar-mars 2018.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-mars 2019




Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2019

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2019 u dominua në masën 66.85% në instrumente afatgjatë (obligacione) dhe pjesa tjetër prej 33.15% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari). Përsa i përket numrit të transaksioneve, 85.14% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2019 flasin për një dominim të transaksioneve “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” dhe “Blerje në tregun primar” përkatësisht me 43.14% dhe 35.12% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, për këtë periudhë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 97% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Letra me vlerë të Qeverisë, janar-mars 2019



Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-mars 2019, ka pasur një rritje prej 1,685 milionë lekë ose 120.99% krahasuar me periudhën janar-mars 2018. Ndërkohë numri i transaksioneve është ulur në masën 24.53%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-mars 2019, ka pasur rritje prej 137 milionë lekë ose 28.10% dhe gjithashtu, një rritje në numrin e transaksioneve në masën 37.36%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, për këtë periudhë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 97% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

ZHVILLIME TË TJERA

AMF pjesëmarrëse në takimet shpjeguese të Komisionit Evropian për Kapitullin e 9-të “Shërbimet Financiare”

Komisioni Evropian, në kuadër të procesit *screening*, organizoi në Bruksel me datë 9-10 prill Takimin Shpjegues me përfaqësuesit e ministrive dhe institucioneve pjesëmarrëse të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut lidhur me Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfaqësua nga drejtues e specialistë të Departamentit Juridik, Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve.



Gjatë zhvillimit të takimeve shpjeguese të Komisionit Evropian

Ekspertët e BE-së dhanë shpjegime dhe prezantuan pikat kryesore të kapitullit të shërbimeve financiare, ndërkohë që delegacioni shqiptar bëri pyetje lidhur me hapat e zbatimit të këtyre direktivave përgjatë procesit të anëtarësimit të vendit drejt BE-së.

Në takim, ekspertët e BE-së prezantuan veprimtarinë e autoriteteve rregullatore evropiane që veprojnë si rregullatorë të tregjeve financiare si European Security and Market Authority (ESMA) dhe European Insurance and Occupational Pensions Authority (EIOPA).

Gjithashtu ato dhanë shpjegime mbi direktivat që i përkasin Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare”, të cilat duhet të përafrohen nga institucionet e shtetit shqiptar në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Si autoritet që mbikëqyr tregun e sigurimeve dhe tregun e kapitaleve ndër direktivat kryesore që lidhen me aktivitetin e AMF-së ishin MIFID, UCITS, *Solvency II*, etj.

Ekspertët e BE-së dhanë shpjegime dhe prezantuan pikat kryesore të kapitullit të shërbimeve financiare, ndërkohë që delegacioni shqiptar bëri pyetje lidhur me hapat e zbatimit të këtyre direktivave përgjatë procesit të anëtarësimit të vendit drejt BE-së.

Takim rajonal për financimin e zvogëlimit të rrezikut të fatkeqësive për Ballkanin Perëndimor

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, UNDP në bashkëpunim me aktorët ndërkombëtarë dhe të sektorit publik, zhvilluan në datë 2 prill në Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë takim rajonal për financimin e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive për Ballkanin Perëndimor.

Vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor kanë një histori me katastrofa natyrore shkatërruese të të gjitha llojeve, të cilat kanë shkaktuar humbje ekonomike dhe njerëzore përgjatë rajonit. Shumica e vendeve të rajonit kanë burime financiare dhe aftësi rimëkëmbjeje fizike të kufizuara. Për më tepër, niveli i parapërgatitjes dhe parandalimit ndryshon nga shteti në shtet dhe bashkëpunimi rajonal nuk ekziston në nivelin e duhur. Mungesa e aftësisë për t'u rimëkëmbur nga katastrofat (e cila gjithnjë e më shumë ka ndikim masiv të rëndësishëm përtej ngjarjes direkte) është një kërcënim në rritje për sigurinë dhe rritjen ekonomike globale.

Për të ndihmuar për adresimin e këtyre sfidave, UNDP është duke punuar me një sërë qeverish dhe partnerësh (publikë dhe privatë) për të zhvilluar mbulimin në sigurim dhe zgjidhjet financiare të riskut. Në sferën e sigurimit për zhvillim, ekspertiza e UNDP mund të përshkruhet si lehtësim i mbledhjeve shumë aktoriale për të diskutuar mekanizmat për financimin e rrezikut, kryerjen e kërkimeve të thelluara të tregut (duke pyetur brezat, arsyet për pak/aspak mbulim) dhe gjetur zgjidhje përmes testimit të fushës.

Për më tepër se një dekadë, UNDP ka lehtësuar mbështetjen për komunitetet vulnerabël përmes partneritetit dhe rritjes së kapacitetit për produktet e makro dhe mikrosigurimit, duke financuar dhe ekzekutuar përshtatjen e vlerësimeve të bëra, dhe më pas duke kontribuar në nxjerrjen e produktit. Duke vazhduar në këtë rrugë, UNDP e ka sigurimin në qendër të axhendës së saj strategjike.

Pavarësisht nga puna deri tani dhe historia e UNDP në këtë sektor, industria e sigurimeve dhe zgjidhjet e produkteve të dala (qoftë në nivel rajonal, kombëtar apo të konsumatorit individ) janë thelbësore për zhvillim të qëndrueshëm dhe për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, të UNDP (*SDG Sustainable Development Goals*).

Takimi i organizuar nga UNDP në bashkëpunim me aktorët ndërkombëtarë dhe të sektorit publik, kishte për qëllim vendosjen e një platformë shumëpalëshe të të interesuarve për ndarjen e njohurive në Ballkanin Perëndimor dhe koordinimin e veprimeve për zhvillimin e sigurimeve dhe financimin e rrezikut.

Vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor kanë një histori me katastrofa natyrore shkatërruese të të gjitha llojeve, të cilat kanë shkaktuar humbje ekonomike dhe njerëzore përgjatë rajonit.

Ndër temat e trajtuara në takim përmendim:

- Humbjet katastrofike të pësuar, mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare e qeverive për t'i përballuar ato dhe penetrimi i ulët i industrisë së sigurimit në të gjithë rajonin, të cilat e bëjnë rajonin një rast për të punuar për aftësinë drejt rimëkëmbjes pas katastrofave;
- Rrugët që duhet të ndiqen nga qeveritë e vendeve, rregullatorët dhe tregu i sigurimeve për të mundësuar financimin e zvogëlimit të riskut të katastrofave;
- Mikrosigurimet - Zgjerimi i tyre në rajon si një alternativë e mirë për grupe shoqërore të cilat nuk kanë mundësi të përballojnë financiarisht skemat klasike të sigurimit.

UNDP mbështet qeveritë e rajonit për të financuar dhe zhvilluar projekte, mundësi dhe produkte për të zbutur pasojat negative që sjellin katastrofat, duke punuar për një zhvillim të qëndrueshëm dhe në përputhje me ndryshimet klimaterike.

Pjesëmarrës në takim ishin përfaqësuesit e qeverive nga vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilët kanë mundësuar zhvillimin e politikave dhe ligjshmërisë, si dhe promovuar mekanizmat e financimit të zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar e zbatuesit e sektorit privat që zhvillojnë dhe menaxhojnë instrumente të ndryshme të financimit të katastrofave.

AMF dërgon për konsultim publik projektligje lidhur me tregun e kapitalit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka dërguar për konsultim publik projektligjin "Për tregjet e kapitalit" dhe projektligjin "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Projektligjet reflektojnë praktikën më të mira evropiane dhe janë bazuar në legjislacionin dhe standardet e BE-së, konkretisht Direktivën MiFID II, Direktivën UCITS dhe Direktivën e AIFM. Hartimi i projektligjeve i shërben objektivit të Shqipërisë për anëtarësim në BE.

Projektligjet janë hartuar në kuadër të Projektit "Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi në Zhvillimin e Tregut të Kapitalit", i financuar nga Sekretariati Shtetëror Zvicëran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe mbështetur nga Banka Botërore.

—○○○—
Autoriteti i Mbikëqyrjes
Financiare ka dërguar
për konsultim publik
projektligjin "Për
tregjet e kapitalit" dhe
projektligjin "Për
sipërmarrjet e
investimeve kolektive".
—○○○—

Zhvillohet trajnimi për subjektet e mbikëqyrura nga Autoriteti

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), organizoi më datë 18 prill 2019 një trajnim për subjektet që mbikëqyren nga Autoriteti.



Gjatë zhvillimit të trajnimit për subjektet që mbikëqyren nga Autoriteti

Autoriteti i Mbikëqyrjes
Financiare në
bashkëpunim me
Drejtorinë e
Përgjithshme të
Parandalimit të Pastrimit
të Parave, organizoi më
datë 18 prill 2019 një
trajnim për subjektet që
mbikëqyren nga
Autoriteti.

Pjesëmarrës në trajnim ishin përfaqësues nga tregjet financiare jobankare si agentë, brokera e shtëpi brokerimi, shoqëri të sigurimit të Jetës, përfaqësues nga shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve, etj.

Ky trajnim është në kuadër të adresimit të rekomandimeve të Komitetit MONEYVAL të Këshillit të Evropës, të cilat janë shoqëruar me ndryshime të akteve rregullative në vend. Drejtues dhe ekspertë nga AMF dhe DPPPP prezantuan ndryshimet ligjore, aktet nënligjore dhe udhëzimet e lidhura me to.

AMF pjesëmarrëse në takimin e tretë të Komitetit Drejtues të Instrumentit Horizontal të Bashkimit Evropian

Ditën e enjte, 4 prill 2019 u përmbyll në Tiranë programi trevjeçar "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë". Ky program është një nismë bashkëpunimi e Bashkimit Evropian dhe e Këshillit të Evropës për vendet e Evropës Juglindore. Programi ka disa komponentë. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është pjesëmarrës në Komitetin Drejtues të këtij programi dhe është përqendruar tek komponenti i luftës kundër krimit ekonomik.

Komponenti i luftës kundër krimit ekonomik ka mbështetur institucionet si AMF, Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave në marrjen e masave për parandalimin dhe hetimin e korrupsionit dhe pastrimit të parave. Kjo është arritur duke zbatuar rekomandimet e dhëna nga Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës Kundër Korrupsionit (GRECO) dhe Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL).

Nëpërmjet këtij projekti, AMF është asistuar për të forcuar Mbikëqyrjen me Bazë Rreziku, si edhe në përditësimin dhe ndryshimin e disa akteve nënligjore. Gjithashtu AMF është ndihmuar për një kuadër rregullator për aktet nënligjore dhe udhëzuesit praktikë, si edhe nëpërmjet trajnimeve të stafit.

Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është një përparësi primare për axhendën e integritetit në Bashkimin Evropian. Programi trevjeçar i Instrumentit Horizontal u zhvillua nga maji 2016 deri në maj 2019.

Rezultatet e Programit të Instrumentit Horizontal në Shqipëri mund të gjenden edhe në faqen zyrtare të Zyrës së Këshillit të Evropës në Shqipëri.

Ditën e enjte, 4 prill
2019 u përmbyll në
Tiranë programi
trevjeçar "Instrumenti
Horizontal për
Ballkanin Perëndimor
dhe Turqinë".

Të kursesh mjaftueshëm, mirë dhe në mënyrë inteligjente

Evropa po plaket dhe kjo përbën një sfidë për qeveritë evropiane për t'u siguruar që njerëzit të kenë të ardhura dinjitoze kur të dalin në pension. "Insurance Europe", Shoqata e Siguruesve dhe Risiguruesve Evropianë ka përgatitur një dokument ku propozohen mënyra që ndihmojnë qytetarët evropianë të kursejnë mjaftueshëm, mirë dhe në mënyrë inteligjente për pensionin e tyre. Shumë vende evropiane kanë nisur tashmë të reformojnë sistemet e tyre të pensioneve. Por kjo nuk është e mjaftueshme. Sipas OECD-së, qytetarët duhet të marrin përgjegjësi personale dhe të japin më shumë kontribut të shtrirë në kohë, nëse duan të kenë të ardhura të përshtatshme për pensionin.

(pjesa e dytë dhe e fundit, me shkurtime e redaktime)

Të kursesh mjaftueshëm

Planifikimi financiar gjithnjë mund të shtyhet lehtësisht. Ka gjithmonë gjëra më të këndshme ose urgjente për të realizuar. Hulumtimet tregojnë se një numër i madh njerëzish nuk kanë njohuri rreth rëndësisë së kursimeve dhe investimeve, menaxhimin e borxhit dhe sigurimin.

T'i bësh njerëzit të mendojnë përtej nevojave të tyre lidhur me pensionin është edhe më e vështirë. Shumë të rinj dhe jo vetëm besojnë se pensionet janë diçka për të cilën duhet të mendojnë në të ardhmen dhe ata gjithmonë i shtyjnë vendimet e tyre në lidhje me pensionit.

Megjithatë, sfidat demografike dhe reformat e kryera në sistemet e pensioneve e bëjnë përgjegjësinë individuale më jetike. Qytetarët duhet të kuptojnë përgjegjësinë e tyre për të kursyer më shumë dhe për të bërë plane për të ardhurat e tyre të pensionit dhe se ata duhet ta bëjnë këtë që në moshë të re. Individët shpeshherë nuk janë të vetëdijshëm për mënyrën se si funksionon sistemi i pensioneve. Shumë prej tyre janë në rrezik të madh për të kuptuar me vonesë se pensionet e tyre nuk do të jenë të mjaftueshme për të siguruar një standard të përshtatshëm jetese.

Prandaj është e domosdoshme që njerëzit të bëhen të vetëdijshëm se duhet të fillojnë të kursejnë sa më shpejtë dhe që duhet të kursejnë mjaftueshëm. Për fat të keq, nëse kthimet e investimeve janë të ulëta, shumat që duhen kursyer duhet të jenë edhe më të mëdha. Ekziston një nevojë e qartë për të rritur ndërgjegjësimin e publikut rreth nevojës për të kursyer mjaftueshëm.

Të kursesh mirë

Mjaftueshmëria e pensioneve në të ardhmen varet jo vetëm nga shuma e kursimeve të njerëzve, por edhe nga kohëzgjatja e kursimit. Përzierja e aktiveve dhe koha e investimit luan një rol shumë të rëndësishëm në garantimin e të ardhurave të përshtatshme për daljen në pension. Kjo është arsyeja pse është kaq jetike që kursimtarët e pensioneve të mund të gëzojnë kthimet e krijuara nga investimet afatgjata në klasa të tilla aktivesh.

Qytetarët duhet të kuptojnë përgjegjësinë e tyre për të kursyer më shumë dhe për të bërë plane për të ardhurat e tyre të pensionit dhe se ata duhet ta bëjnë këtë që në moshë të re.

Në praktikë, ekzistojnë një sërë barrierash që parandalojnë strategjitë optimale të alokimit të mjeteve për pensionet afatgjata.

- Së pari, shmangia e rrezikut mund t'i largojë njerëzit nga investimet në klasa aktivesh me kthime të larta. Kthimet mesatare nga kapitalet dhe pronat janë më të larta se klasat e tjera të aktiveve, por rreziku i kthimit të dobët ose negativ për kursimtarët individualë është gjithashtu më i madh, sepse afati i investimit ka mjaft ndikim.

Hulumtimi i sjelljes tregon se përgjithësisht individët kanë tendencë të shprehin kundërshtime kundrejt rrezikut dhe nuk janë shumë të aftë në marrjen e vendimeve të investimit racional afatgjatë. Vendimet e njerëzve janë subjekt i paragjyqimeve të veçanta dhe vendimet e tyre rreth investimeve të pensioneve nuk janë të ndryshme.

Disa nuk mund të kenë aftësi për të marrë vendime të përshtatshme ose të mbështeten në tregues të gabuar, p.sh. performanca e kohëve të fundit. Disa mund të kenë besim të tepruar në vetvete dhe të investojnë ose të shesin në momentin e gabuar. Disa të tjerë mund të tentojnë të shtyjnë vendimet kyçe dhe të humbasin mundësi të mira.

Kjo sjell më pak investime në përgjithësi, më pak investime në aktivet e duhura ose vendime të marra në momentin e gabuar.

- Së dyti, investimet në aktivet e caktuara jolikuide si infrastruktura janë arsye të mira, por shpesh të kufizuara në investitorët institucionalë. Prandaj kursimtarët individualë, veçanërisht ata më pak të pasur, nuk kanë qasje në këto aktive.

Një mënyrë e thjeshtë dhe më pak e rrezikshme për individët për të fituar ekspozim ndaj një game të gjerë aktivesh është ajo përmes produkteve tradicionale të sigurimeve, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e garancive dhe lehtësimin e kthimeve. Megjithatë, siguruesit përballen me sfida që mund të kufizojnë aftësinë e tyre për të ofruar produkte të tilla dhe kjo na sjell një pengesë tjetër; *Solvency II* - Rregullorja e BE-së që rregullon kërkesat e kapitalit të siguruesve – e ka rritur koston e siguruesve që investojnë në asete që mund të ofrojnë kthime të arsyeshme për mbajtësit e policave. Kjo ka ardhur për shkak të kostove të larta të kapitalit dhe luhatshmërisë së bilancit.

Një paqëndrueshmëri e tillë në rezultatet e raportimit financiar mund të krijojë vështirësi për investime afatgjata. Për më tepër, shqetësimi i administrimit lidhur me ndikimin në aftësinë pagueuse të kompanisë së tyre për të investuar në këto aktive ka kontribuar në një reduktim në investimet në aktive me performancë më të lartë, siç janë aksionet dhe infrastrukturat.

Vendimet e njerëzve janë subjekt i paragjyqimeve të veçanta dhe vendimet e tyre rreth investimeve të pensioneve nuk janë të ndryshme.

Në përgjithësi, masat e *Solvency II* janë duke e rritur artificialisht paqendrueshmërinë e bilancit dhe ato që duhet të mbajnë siguruesit e kapitalit, duke shkaktuar dëme të panevojshme të kthimit të pensioneve. Rregullimet janë të nevojshme nëse këto masa duhet të kapin me saktësi rreziqet dhe natyrën e vërtetë të modelit të biznesit të sigurimit të Jetës.

Të kursesh në mënyrë inteligjente

Niveli i kulturës financiare është i ulët në pjesën më të madhe të vendeve, duke përfshirë edhe vendet e zhvilluara. Individët në përgjithësi kanë mungesë njohurish të financave dhe produkteve financiare, por disa besojnë se kanë më shumë kulturë financiare sesa duken realisht. Një element thelbësor në pajisjen e njerëzve me aftësitë e duhura për të marrë vendime të informuara rreth pensioneve është duke u siguruar që të kenë edukim financiar të mjaftueshëm.

Një kuptim më i mirë i ekonomisë dhe financave të përgjithshme fuqizon individët. Ata bëhen të aftë për të marrë përgjegjësinë për planifikimin dhe menaxhimin e të ardhmes së tyre financiare, kanë më shumë gjasa të veprojnë në mënyrë racionale gjatë vështirësive financiare dhe kuptojnë më mirë efektin e vendimeve financiare në jetën e tyre të përditshme. Vetëm kur konsumatorët të jenë të pajisur me aftësitë e nevojshme financiare dhe besimin për t'i përdorur ato, atëherë do të jenë në pozitën për të kërkuar dhe kuptuar informacionin që u jep mundësi të marrin vendime të mira në lidhje me investimet dhe planifikimin e daljes në pension. Gjithashtu do të sigurohen që të kenë të ardhura gjatë moshës së pensionit që plotësojnë nevojat dhe pritshmëritë e tyre.

Së bashku me edukimin e nevojshëm financiar është thelbësore që të ketë transparencë të produktit, e cila ndihmon individët të marrin vendime të informuara rreth pensioneve. Informacioni i dhënë për produktet e pensioneve duhet të jetë i përshtatshëm për aftësitë dhe nevojat e qytetarëve dhe, më e rëndësishmja, duhet të hartohet në mënyrë specifike për t'iu përshtatur pensioneve. Një shembull që nuk ka të bëjë me këtë rast është i lidhur me sugjerimet nga Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) rreth debatit mbi mundësinë e krijimit të një produkti pensionesh pan-evropian (PEPP). EIOPA propozon të përdorë Dokumentin Kryesor të Informacionit (KID) të kërkuar në Rregulloren e BE-së në lidhje me Paketën e Produkteve me Pakicë dhe Investimeve të Bazuara në Sigurime (PRIIPs) si pikë fillestare për dhënien e informacioneve para-kontraktuale për produktet e Sigurimeve të Pensioneve. Rregullorja e PRIIP-it përjashton në mënyrë specifike produktet e lidhura me pensionet.

Vetëm kur konsumatorët të jenë të pajisur me aftësitë e nevojshme financiare dhe besimin për t'i përdorur ato, atëherë do të jenë në pozitën për të kërkuar dhe kuptuar informacionin që u jep mundësi të marrin vendime të mira në lidhje me investimet dhe planifikimin e daljes në pension.

GLOBAL RISK REGULATOR

Volumi 17, nr. 4, prill 2019 përmban këto shkrime kryesore:

Global Risk Regulator

A PUBLICATION FROM THE BANKER April 2019 | Volume 17, Issue 4

Contents

- 10 ECB takes over indirect supervision of PNB Banks
- 11 research unbundling only not part of story
- 12 Regulatory knowledge
- 13 MIFID II makes global impact
- 14 Fintech risks
- 15 Have two-phase impact on credit supply
- 16 Bond
- 17 Digitalisation may not break 'boom loop' for European banks
- 18 Newsrooms (15-18)
- 19 ECB to decide on treatment of crypto-assets (19-20)

Corporate leveraged loans could face more rules after FSB investigation

Could the corporate leveraged loans market be harbouring some dark secrets that threaten to morph into another global financial crisis? It is a question that is currently preoccupying the FSB with the looming prospect of more regulation for the sector. By Justin Pugliese

The US Office of the Comptroller of the Currency, the Bank of England, former Federal Reserve Board chairwoman Janet Yellen, and the International Monetary Fund have raised concerns over the growth of the corporate leveraged loan market. It is therefore hardly surprising that the Financial Stability Board (FSB), with its 25 member states to staff out financial stability, is investigating. A look down at the market suggests it has some similar characteristics that can lead to systemic risk. There is high leverage, investors

being sold and there's been a similar investment that spread in the 2007 global financial crisis - a structured product known as collateralised loan obligations (CLOs), similar to collateralised debt obligations. CLOs are securitisation loans that together make corporate loans and then taking them into tranches with varying degrees of risk.

- MIFID II ka ndikim global
(MIFID II makes global impact)
- Revolucioni teknologjik rrezikon të krijojë pika të errëta në mbikëqyrje
(Fintech revolution risks creating new supervision blind spots)
- Rreziku i digjitalizimit: Mos i jepni ende robotëve liri veprimi
(Digitising risk: don't give the robots free-rein just yet)

Bosnje dhe Hercegovinë

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Sigurimeve në Bosnje dhe Hercegovinë (AZOBiH), në vitin 2018 tregu i sigurimeve realizoi 713 milionë BAM (marka, monedha vendase) ose 365 milionë euro. Ky volum është 4.4% më shumë sesa në vitin 2017. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës arritën në 73.3 milionë euro, me një peshë tregu prej 20.1%. Ndërsa primet në sigurimin e Jo-Jetës arritën në 291.7 milionë euro.

Maqedoni e Veriut

www.xprimm.com

Sipas të dhënave paraprake të Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimeve (ISA), primet e shkruara bruto në tregu e sigurimeve në Maqedoninë e Veriut për vitin 2018 ishin 161.4 milionë euro, me një rritje prej 10.4% krahasuar me një vit më parë. Sigurimi i Jetës u rrit me 15.5%, duke arritur në 27.2 milionë euro prime të shkruara bruto. Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 9.4%, duke arritur në 134.3 milionë euro prime të shkruara bruto.

Siguruesit paguan 64 milionë euro dëme, ose 9.5% më shumë sesa në vitin 2017.

Qipro

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Qipro e mbylli vitin 2018 me 871.4 milionë euro prime të shkruara bruto, me një rritje prej 7%, sipas të dhënave të paraqitura nga Shoqata e Sigurimeve në Qipro (IAC). Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës arritën në 492.6 milionë euro, me një rritje vjetore prej 5.6%.

Sigurimi i Jetës ndoqi tendencën pozitive të rritjes, duke arritur në 378.9 milionë euro prime të shkruara bruto, 8.8% më shumë se në vitin 2017. Dëmet e paguara arritën në 490 milionë euro, me një rritje të lehtë krahasuar me vitin paraardhës.

Serbi

www.xprimm.com

Në vitin 2018, tregu i sigurimeve në Serbi realizoi 845 milionë euro prime të shkruara bruto, me një rritje prej 7.6%. Kjo rritje erdhi më së shumti për shkak të sigurimit të Jo-Jetës, i cili u rrit me 8.5%, duke arritur në 644 milionë euro prime të shkruara bruto. Sigurimi MTPL vijon të zërë pjesën kryesore të tregut (mbi 33%), duke u rritur me 5.2% në krahasim me vitin 2017.

Sllovaki

www.xprimm.com

Në vitin 2018, tregu i sigurimeve në Sllovaki realizoi 2.2 miliardë euro prime të shkruara bruto, sipas të dhënave paraprake të publikuara nga Banka Qendrore e Sllovakisë (NBS). Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës ishin 1.02 miliardë euro, me një rënie prej 4.26%.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës ishin 1.18 miliardë euro, me një rritje prej 7.9%. Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit u rrit me më shumë se 100 milionë euro, duke arritur në 1.32 miliardë euro.

Parlamenti Evropian forcon mbikëqyrësit financiarë në BE

www.xprimm.com

Deputetët e Parlamentit Evropian miratuan disa rregulla që forcojnë mbikëqyrjen financiare në BE, në kuadër të tregjeve më të sigurta, luftës kundër pastrimit të parave dhe mbrojtjes së konsumatorëve. Ligji i ri, i miratuar në muajin prill, parashikon një përmirësim të funksionimit të autoriteteve rregullatore të BE-së, të krijuara në vitin 2010.

Ligji pritet të sjellë tre ndryshme të rëndësishme në tregjet financiare: më shumë fuqi financiare për mbikëqyrësit, rritje të kompetencave për rregullatorët kombëtarë në drejtim të mbrojtjes konsumatore, rol më të madh për Autoritetin Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) dhe Autoritetin Evropian të Bankave (EBA) në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al